



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

RAPORT VJETOR

**KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
PËR VITIN 2018**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është themeluar në bazë të nenit 12, pika d e Ligjit nr. 03 – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe dispozitave të nenin 7 të Ligji nr. 04/L-076, për policinë.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është themeluar më 3 maj të vitit 2018, i cili ka 30 anëtarë, është punuar sipas Planit të veprimit dhe Plani dinamik, të miratuar nga anëtarët e KKSB-së.

Në Komunën e Prishtinës janë te formuara 5 (pesë) Këshilla Lokal për Siguri në Bashkësi (KLSP), të cilët i kanë mbajtur takimet e rregullta mujore (12 takime), dhe është funksional Ekipi Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB), i cili i ka mbajtur dy takime. Komuna e Prishtinës na ka krijuar kushte të favorshme për mbajtjen e të gjitha takimeve të rregullta të KKSB-së, gjithsej gjashtë.

KKSB është organ këshillues – konsultues për çështje të sigurisë, me përfaqësim të gjërë të të gjitha bashkësive të Komunës, si dhe përfaqësues të Shoqërisë civile, duke marrë parasysh edhe kriteret e përfaqësimit gjinor, i cili në bashkëpunim me policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë për bashkësi në të mirë të të gjithë qytetarëve të komunës, dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës ose nënkyetari i Komunës.

Parimi kryesor i KKSB-së gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë kryesisht i përqendruar në aktivitete për çështje të sigurisë, në bashkëpunim me policinë dhe qytetarët, si dhe me forumet, organizatat tjera të sigurisë, KLSP-të, EVSB-të dhe përfaqësuesit e Shoqërisë civile, për të identifikuar dhe shqyrtaur çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

KKSB-ja ka pasur si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcenojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive qe lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshmë me te gjitha komunititetet që jetojnë në territorin e komunës së Prishtinës.

*Në takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, gjatë vitit 2018
janë trajtuar këto çështje:*

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit të KKSBB-së për vitin 2018, Dinamika e punës përvitit 2018, miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura, çështjen e sigurisë në komunën e Prishtinës, përgatitjet përfushatën e korrje-shirjeve në territorin e komunës, kthimi i qytetarëve tanë me banim dhe punësim të përkohshëm në botën e jashtme, trafikimi i qenieve njerëzore dhe përdorimi i substancave narkotike, fajdeve, terrorizmi dhe radikalizmi, si dhe dukuri te ngjashme negative, çështjet e arsimit në institucionet shkollore dhe parashkollore, transporti në viset rurale, pajisjet me kamera dhe sigurimi fizik i objekteve shkollore, uzurpimet e hapësirave publike, taksi ilegale, vendosja e shtyllave antiparking, ndriçimi publik hapësirave publike dhe parqeve, krasitja e drurëve që paraqesin rrezik përfshirë qytetarë, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, trotuareve, pastrimin e pushtave të ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza, qentë endacakë, mbylljen e gropave në rrugë dhe hapësira publike, transporti publik në vise rurale, organizimi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative, kulturore përfshirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërfetar, marrja e masave parandaluese përmirësimi përdorimit të mjetave piroteknike gjatë festave të fundit etj.

Të gjitha takimet e KKSBB-së janë kryesuar nga nënkyetari i Komunës së Prishtinës, z. Selim Pacolli, i cili pas propozimit të rendit të ditës, është marrë më vërejtjet, sugjerimet, kërkesat dhe ankesat e të gjithë anëtarëve të KKSBB-së, si dhe zgjidhjen e tyre në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive përkatëse.

Komandantët e stacioneve të policisë kanë raportuar në çdo takim përfshirë gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Prishtinës. Bashkëpunimi i Policisë me Komunën, anëtarë të KKSBB-së, si dhe qytetarë ka qenë në nivel shumë të lartë.

Përfaqësuesit e KLSP-ve kanë parashtruar shumë kërkesa dhe ankesat e qytetarëve, ku shumica prej tyre janë realizuar. Përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe komuniteteve kanë qenë falenderues sa i përket sigurisë nga ana e policisë së Kosovës, si dhe nga ana e Komunës së Prishtinës, përfshirë bashkëpunim dhe zgjidhjen e kërkesave të parashtruara. Ka pasur diskutime të ndryshme nga të gjithë anëtarët e KKSBB-së, FSK-së, përfaqësuesit e prindërve dhe OJQ-ve përfshirë probleme të ndryshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Prishtinës.

Në takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e OSBE-së, të KFOR-it dhe të MPB-së, Divizioni përfshirë Siguri.

Të gjitha diskutimet, vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSBB-së, janë diskutuar, shqyrtuar nga përfaqësuesit kompetentë të organeve komunale dhe janë dërguar në drejtori përkatës përfshirë shqyrtim dhe është kërkuar zgjidhja e tyre sa më shpejtë që është e mundur, është përgatitet plani i veprimit dhe është raportuar në takimin e radhës etj. Vlen të theksohet se shumica prej tyre janë zgjidhur.



Rezultatet e arritura nga takimet e KKSBS-së për vitin raportues 2018:

- Kërkesa e parashtruar nga komandanti i Stacionit policor "Veriu" në lagjen "Kodra e Trimave", për ndarjen e një parcele për ndërtimin e objektit të Stacionit të policisë, është realizuar (caktuar lokacioni) dhe është miratuar nga këshilltarët e Kuvendit të Komunës;
- Caktimi i një lokacioni për varrosjen e kafshëve të ngordhura, ku ka pasur protesta nga banorët e komunitetit në Bërnicë, është caktuar përkohësisht;
- Policia e Kosovës në bashkëpunim me inspektorët komunalë, kanë ndërmarrë disa aksione për kontrollimin e lokaleve të natës për parandalimin: e zhurmës, drogës, prostitucionit, si dhe dukurive të tjera negative;
- Institucionet komunale janë marrë më shumë me pastrimin e pusetave të ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza, mbylljen e gropave në rrugë, mbushjen e gropave të hapura nga kompanitë private në pjesë të ndryshme të qytetit në një thellësi deri në dy metra, ndriçimin e rrugëve, hapësirave publike dhe parqeve në ato pjesë ku ka munguar ndriçimi, e sidomos afér institucioneve fetare, si dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit, intervenime në shumë deponi ilegale të mbeturinave, në parkingje ilegale, me shtylla antiparking, vendoja e pengesave në rrugë, pastrimin e lumenjve pas reshjeve atmosferike, vendosjen e shenjave të komunikacionit, Identifikimin, rrithimin dhe mbylljen me kapak nga betoni i puseve (bunarëve) ku kanë qenë të hapura, si masë parandaluese të ndonjë fatkeqësi, prerjen e drunjëve që janë rrezikuar qytetarët nga rrëzimi i tyre, mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve;
- Trajtimi i qenve endacakë, në bashkëpunim me AVUK-në;
- Lëshimi i një linje të autobusëve për bartjen e nxënësve dhe banorëve në disa fshatrat të Gollakut;
- Largimi nga trafiku i takrive ilegale, lirimi i pronave të uzurpuara në hapësira publike;
- Policia e Kosovës së bashku me institucionet komunale, janë angazhuar për bashkatdhetarët të cilët janë kthyer për pushime në vendlindje, që të shërbehen më lehtë dhe më shpejt me shërbime komunale, parkingje të automjeteve, sigurinë etj;
- Vendosja e kamerave në shkolla dhe një pjesë të qytetit;
- Marrja e masave të duhura për korrje-shirje;
- Marrja e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fundë vitit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur të gjitha takimet e rregullta të KKSBS-së, të gjitha materialet për mbajtjen e takimeve u janë dorëzuar me kohë anëtarëve dhe pjesëmarrësve të cilët janë ftuar në takime. Procesverbalet e miratuara nga anëtarët e KKSBS-së u janë dorëzuar ministrive përkatëse, MAPL-së dhe MPB-së - Divizioni për Siguri.

08.01.2019
Koordinator i KKSBS-së
Fatmir Bilalli




Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti